

## **RREGULLORE E BRENDSHME**

### **PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI<sup>1 2 3</sup>**

#### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Objekti i rregullores**

1. Kjo Rregullore e Brendshme përcakton rregullat e funksionimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në realizimin e mbledhjeve dhe veprimtarive të tij, sipas detyrimeve që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

##### **Neni 2 Përkufizime**

1. Për qëllim të kësaj Rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Këshilli” është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në ushtrim të kompetencave në mbledhjet ose në veprimtaritë e tij të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligj.
- b) “Subjekte që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi” janë Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë, për kandidatët që kanë shprehur interes për tu zgjedhur gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kandidatët që kanë shprehur interes pranë Këshillit, për t’u zgjedhur Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
- c) “Kandidatë” janë, sipas rastit, personat që kandidojnë për t’u zgjedhur anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe/ose Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
- ç) “Papajtueshmëria” përfshin marrëdhëniet që ekzistojnë ndërmjet anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe kandidatit në rastet e përcaktuara nga neni 223 i ligjit nr.115/2016.
- d) “Konflikt i interesit” përfshin të gjitha gjendjet dhe rastet e parashikuara nga nenet 222 dhe 224 të ligjit nr.115/2016 , si edhe nga dispozitat e ligjit nr. 9367/2005.
- dh) “Pengesë ligjore” përfshin të gjitha gjendjet dhe rastet e parashikuara nga neni 30 i Kodit të Procedurave Administrative.
- e) “Pamundësi objektive” përfshin të gjitha rastet kur anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është në mungesë për shkaqe të përligjura në përmbushjen e detyrimeve të tij në mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit.

##### **Neni 3 Selia e Këshillit**

---

<sup>1</sup> Miratuar me vendimin nr. 1, datë 08.02.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

<sup>2</sup> Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 05.02.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

<sup>3</sup> Ndryshuar me vendimin nr.5, datë 10.07.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

1. Selia e Këshillit është në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë në adresën: Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

#### **Neni 4**

##### **Vula e Këshillit**

1. Këshilli ka vulën e tij zyrtare, e cila ruhet dhe administrihet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Vula e Këshillit përmban stemën e Republikës së Shqipërisë, e rrethuar me mbishkrimin: “Republika e Shqipërisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi”.

## **KREU II**

### **FUNKSIONIMI I KËSHILLIT**

#### **Seksioni 1**

##### **Kostituimi i Këshillit, mandati i anëtarëve dhe detyrimet e tyre**

#### **Neni 5**

##### **Kostituimi i Këshillit**

1. Kostituimi i Këshillit deklarohet në mbledhjen e parë të tij.
2. Mbledhja e parë e Këshillit mbahet jo më vonë se e hëna e tretë e muajit janar.
3. Në mbledhjen e parë të Këshillit marrin pjesë të gjithë anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të zgjedhur me short në këtë detyrë, Avokati i Popullit, si edhe subjektet që ftohen sipas pikës 2 të nenit 233 të ligjit nr. 155/2016.

#### **Neni 6**

##### **Mandati i anëtarit dhe anëtarit zëvendësues të Këshillit**

1. Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi qëndrojnë në detyrë për 1 vit nga data 1 janar e çdo viti kalendarik.
2. Në rast të pezullimit nga funksioni i gjyqtarit, prokurorit ose të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, anëtari i Këshillit, përkohësisht, zëvendësohet nga anëtari zëvendësues sipas ligjit.
3. Në rast të ndërprerjes nga funksioni i gjyqtarit, prokurorit ose të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, anëtari i Këshillit, për pjesën e mbetur të vitit kalendarik, zëvendësohet nga anëtari zëvendësues sipas ligjit.

#### **Neni 7**

##### **Detyrimi i pjesëmarrjes në mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit**

1. Pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit në mbledhjet dhe veprimtaritë e tij është e detyrueshme përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të kësaj detyre.

2. Anëtarët e Këshillit që janë në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore zëvendësohen nga anëtarët përkatës zëvendësues sipas ligjit, të cilët, në raste të tilla, janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit.

3. Anëtarët zëvendësues kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit, në rastet kur realizohet puna përgatitore ose kur në rendin e ditës, shqyrtohen çështje nga ato të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 8 të kësaj Rregulloreje të Brendshme.

## **Seksioni 2** **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi**

### **Neni 8** **Kompetencat e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

1. Këshilli ushtron kompetencat që i janë ngarkuar nga Kushtetuta, ligjet e nxjerra në pajtim me të, aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të ligjit dhe, në mënyrë të veçantë, kompetencat e mëposhtme :

a) shqyrton dhe vendos për çështjet e lidhura me procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore, të pasurisë, integritetit, të shkuarës profesionale e personale, si edhe me procedurat e vlerësimit të kriterëve profesionale e morale për përzgjedhjen, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë,

b) miraton aktet nënligjore normative dhe aktet e tjera rregullatorë të brendshme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit, të cilat i janë deleguar për ti nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 115/2016 ose të legjislacionit të zbatueshëm për Këshillin,

c) shqyrton dhe miraton kërkesat dhe nevojat e Këshillit për mbështetje me personel dhe për mbështetje administrative, organizative e financiare nga Gjykata e Lartë,

ç) shqyrton dhe miraton masat e veprimet lidhur me mbështetjen dhe bashkëpunimin e Këshillit me organe shtetërore, institucione ndërkombëtare, si edhe organizata të tjera me objekt veprimtarie ose ekspertizë të lidhur me qëllimet e përmbushjes së kompetencave dhe veprimtarive të Këshillit,

d) shqyrton dhe miraton masat e nevojshme për mirëorganizimin e mbledhjeve dhe të veprimtarive të Këshillit.

dh) krijon grupe pune për të përgatitur projektakte, programe, dokumente strategjike apo materiale të nevojshme për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit.

2. Mbledhja e Këshillit ushtron edhe çdo kompetencë tjetër të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e tij, me përjashtim të kompetencave dhe detyrave të cilat ligji ia ngarkon Kryetarit të Këshillit ose një anëtar të tij kur ky i fundit ushtron detyrat në cilësinë e relatorit.

### **Neni 9** **Përgatitja e mbledhjeve të Këshillit**

1. Në përgatitjen mbledhjeve të Këshillit dhe përcaktimin e çështjeve të rendit të ditës, Kryetari dhe anëtarët e Këshillit vlerësojnë rëndësinë dhe përparësinë e çështjeve, veçanërisht nisur nga rastet dhe nevojat e Këshillit për të respektuar afatet, procedurat dhe detyrimet e tjera ligjore, si edhe detyrat e përcaktuara nga vendimmarrjet përkatëse të mbledhjeve të mëparshme të Këshillit.

2. Përcaktimi i çështjeve të rendit të ditës dhe caktimi i ditës së zhvillimit të mbledhjes së Këshillit bëhet nga Kryetari, duke mbajtur parasysh mendimin e anëtarëve relatorë të çështjeve dhe detyrat e lëna në mbledhjet e mëparshme. Në rendin e ditës përfshihen edhe çështjet që mund të propozohen, me shkrim, nga secili prej anëtarëve të tjerë të Këshillit. Nëse dita e mbledhjes së Këshillit është paracaktuar në mbledhjen paraardhëse, njoftimi i anëtarit për çështje që duhet të përfshihen në rendin e ditës duhet të paraqitet jo më vonë se tre ditë nga ajo e caktuar për zhvillimin e mbledhjes.
3. Për përgatitjen e çështjeve të rendit të ditës dhe të dokumentacionit përkatës, Kryetari i Këshillit, anëtarët relatorë dhe nismëtarë për çështjet përkatëse, mbështeten nga personeli administrativ i Gjykatës së Lartë.

## **Neni 10**

### **Thirrja dhe kohëzgjatja e mbledhjeve të Këshillit**

1. Këshilli mblidhet sa herë është e nevojshme.
2. Mbledhja paraardhëse e Këshillit, përpara përfundimit të saj, diskuton dhe vendos, nëse e vlerëson të nevojshme, për rendin e ditës, datën dhe kohën e zhvillimit të mbledhjes pasardhëse.
3. Nëse nuk është vendosur ndryshe nga mbledhja e mëparshme e Këshillit, mbi bazën e punës përgatitore dhe propozimeve të tjera eventuale të anëtarëve, Kryetari thërret mbledhjen dhe vendos rendin e ditës, datën dhe kohën e zhvillimit të saj.
4. Në rastet kur kërkohet me shkrim, nga të paktën një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Këshillit në datën, kohën dhe me rendin e ditës të përcaktuar nga anëtarët nismëtarë.
5. Në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore të Kryetarit, veprimet përgatitore dhe thirrja e mbledhjes kryen nga Zëvendëskryetari.
6. Në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore si të Kryetarit ashtu edhe të Zëvendëskryetarit, mbledhja e Këshillit mund të thirret nga një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, të cilët propozojnë edhe datën, kohën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Në këtë rast, puna përgatitore dhe mbledhja e Këshillit drejtohet nga anëtari i Këshillit më i vjetër në moshë.
7. Kryetari përcakton në njoftimin e thirrjes së mbledhjes nëse për shqyrtimin e çështjeve të rendit të ditës Këshilli do të qëndrojë i mbledhur për një kohë më të gjatë se dita e caktuar për fillimin e mbledhjes. Në këto raste, Këshilli qëndron i mbledhur deri në përfundim të shqyrtimit të çështjeve, veçanërisht nëse ky detyrim përcaktohet nga ligji ose aktet nënligjore të miratuar nga Këshilli apo kur nisur nga natyra komplekse dhe e ndërvarur e çështjeve nevojitet përfundimi i shqyrtimit të tyre në funksion të respektimit të afateve dhe detyrimeve të caktuara ligjore.

## **Neni 11**

### **Njoftimet për thirrjen e mbledhjes së Këshillit**

*(Shtuar fjalë në pikën 10 me vendimin nr.1, datë 05.02.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi)*

1. Nëse nuk është vendosur ndryshe në mbledhjet e mëparshme të Këshillit, njoftimi për thirrjen e mbledhjes, i cili përmban rendin e ditës, datën, kohën e zhvillimit të mbledhjes, bëhet me shkrim së paku 5 ditë përpara datës që caktohet për zhvillimin e saj. Thirrja dhe njoftimi i mbledhjes bëhet edhe përpara këtij afati, nëse lind nevoja për të respektuar procedurat dhe

afatet e caktuara nga ligji dhe aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli, si edhe në varësi të rrethanave dhe natyrës së çështjes.

2. Përveç kur ligji dhe aktet nënligjore të Këshillit përcaktojnë një afat tjetër, njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet menjëherë dhe ajo zhvillohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e publikimit të listës së kandidatëve nga subjektet që vënë në lëvizje Këshillin ose ajo e përfundimit të afatit të paraqitjes së kandidaturave në Këshill për Inspektor të Lartë të Drejtësisë apo ajo e përfundimit të procedurave të verifikimit të kandidaturave.

3. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes, i cili përmban rendin e ditës, datën, kohën e zhvillimit të mbledhjes, i dërgohet të gjithë anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të Këshillit.

4. Së bashku me njoftimin për thirrjen e mbledhjes, sipas rasteve dhe natyrës së çështjeve të rendit të ditës, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme të komunikimit, anëtarëve të Këshillit u dërgohet edhe dokumentacioni përkatës i përgatitur nga anëtarët relatorë të çështjes.

5. Në rastet kur, përpara ditës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes apo për thirrjen e saj, Kryetari ka ardhur në dijeni të pamundësisë objektive ose të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit apo të pengesës të anëtarit të Këshillit për të marrë pjesë në mbledhje ose për çështje të caktuara të rendit të ditës, për shkak të heqjes dorë të pranuar ose përjashtimit të tij për motivet parashikuara nga ligji, dokumentacioni përkatës i përgatitur nga anëtarët relatorë të çështjes, i dërgohet menjëherë anëtarit zëvendësues të Këshillit, së bashku me njoftimin për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit.

6. Në rastet kur, pas thirrjes së mbledhjes, njoftohet nga anëtari i Këshillit ose vjen në dijeni edhe kryesisht, lidhur me pamundësinë objektive të pjesëmarrjes së tij në mbledhje, Kryetari procedon menjëherë me njoftimin e dytë të posaçëm të anëtarit zëvendësues për këtë rrethanë dhe për detyrimin e këtij të fundit të marrë pjesë në mbledhje, duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës të përgatitur nga anëtarët relatorë të çështjeve të rendit të ditës.

7. Anëtari i Këshillit dhe/ose anëtari zëvendësues, menjëherë pas njoftimit të mbledhjes ose në çastin kur vjen në dijeni të rrethanave konkrete të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit apo pengesës ligjore, lidhur me çështjet e rendit të ditës apo një pjesë të tyre, duhet të njoftojë Kryetarin duke i parashtruar menjëherë edhe kërkesën e arsyetuar me vlerësimin e tij për motivet e ekzistencës së këtyre shkaqeve.

8. Në rastet kur Kryetari njoftohet nga anëtari i Këshillit lidhur me rrethana konkrete të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit apo pengesës ligjore për pjesëmarrjen e tij në mbledhje ose për çështje të caktuara të saj, Kryetari vepron menjëherë sipas ligjit për të disponuar pranimin ose jo të kërkesës së heqjes dorë apo mbi përjashtimin e tij. Në rast të pranimit të heqjes dorë ose të vendimit të përjashtimit, Kryetari procedon menjëherë me njoftimin e anëtarit zëvendësues për detyrimin e pjesëmarrjes në mbledhje, duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës të përgatitur nga anëtarët relatorë të çështjeve të rendit të ditës.

9. Njoftimi i anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të Këshillit për zhvillimin e mbledhjes bëhet në rrugë shkresore, me anë të postës, korrierit, në rrugë elektronike apo të çdo mjeti tjetër të përshtatshëm komunikimi.

10. Me të njëjtat mjete komunikimi dhe brenda të njëjtave afate, njoftimi që përmban rendin e ditës, datën dhe kohën e zhvillimit të mbledhjes i bëhet Avokatit të Popullit, si edhe subjekteve të tjera që sipas ligjit ftohen nga Këshilli për të marrë pjesë në mbledhjet e tij. Së bashku me njoftimin, Avokatit të Popullit i dërgohet dokumentacioni përkatës i përgatitur nga anëtarët relatorë të çështjeve të rendit të ditës, ndërsa subjekteve të ftuara, ky dokumentacion, u dërgohet nëse nuk ekzistojnë kufizime sipas ligjit dhe akteve nënligjore normative të miratuara nga Këshilli lidhur me procedurat e verifikimit dhe të vlerësimit e renditjes së kandidaturave.

## Neni 12

## **Drejtimi i mbledhjeve të Këshillit**

1. Mbledhja e Këshillit drejtohet nga Kryetari.
2. Në rast pamundësie objektive ose papajtueshmërie, konflikti të interesit apo pengese ligjore të Kryetarit mbledhja drejtohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit.
3. Në rast pamundësie objektive ose papajtueshmërie, konflikti të interesit apo pengese ligjore edhe të Zëvendëskryetarit, mbledhja e Këshillit drejtohet nga anëtari i pranishëm më i vjetër në moshë.

### **Neni 13**

#### **Pjesëmarrësit në mbledhjet e Këshillit**

1. Në mbledhjet e Këshillit marrin pjesë anëtarët e Këshillit. Në pamundësi objektive ose papajtueshmëri, konflikt të interesit apo pengesë ligjore të tyre në mbledhje marrin pjesë anëtarët përkatës zëvendësues.
2. Avokati i Popullit, nëse e vlerëson të jetë i pranishëm, merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit. Në mungesë të tij, Avokati i Popullit mund të përfaqësohet nga njëri prej komisionerëve.
3. Në cilësinë e të ftuarit, nëse e vlerësojnë të jenë të pranishëm, në mbledhjet e Këshillit marrin pjesë përfaqësues nga subjektet e përcaktuar në pikën 2 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
4. Rast pas rasti, sipas përcaktimeve të ligjit ose të nevojave për mbështetje me konsulencë apo njohuri të posaçme, Këshilli angazhon dhe thërret në veprimtaritë dhe mbledhjet e tij ekspertë apo subjekte me njohuri të posaçme të fushës përkatëse.

### **Neni 14**

#### **Procedura në rast papajtueshmërie dhe konflikti të interesit**

1. Anëtari i Këshillit ose anëtari zëvendësues, nëse ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, nuk merr pjesë në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit të lidhura me çështje që kanë për objekt përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e rregullave normative të shortit, verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, si edhe në procedurat konkrete të shqyrtimit të kandidimeve për pozicionet vakante.
2. Në rastin kur në lidhje me çështje të caktuara që trajtohen në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit, anëtari i Këshillit ose anëtari zëvendësues vjen në dijeni të rrethanave të tilla që, sipas ligjit, e vendosin atë vetë ose një anëtar tjetër, përpara njërit prej rasteve të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, njofton menjëherë Kryetarin e Këshillit dhe deklaron arsyet konkrete që sjellin pengesë për pjesëmarrjen në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e çështjes përkatëse.
3. Në rastin kur në lidhje me çështje të caktuara që trajtohen në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit, anëtari i Këshillit ose anëtari zëvendësues janë përpara njërit prej rasteve të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore dhe mospjesëmarrja e tyre sjell pamundësinë e ushtrimit të kompetencave, përfshirë uljen e kuorumit të mbledhjes së Këshillit në më pak se pesë anëtarë, atëherë rasti merret në shqyrtim menjëherë nga mbledhja e Këshillit dhe, në respektim të parimit të funksionalitetit e për të mos bllokuar

veprimtarinë dhe vendimmarrjen e tij, Këshilli vendos për mënyrën e procedimit që garanton ushtrimin e kompetencave të tij.

4. Në rastin kur në lidhje me çështje të caktuara që trajtohen në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit, përfaqësuesi nga institucioni i Avokatit të Popullit ose përfaqësues nga subjektet që ftohen sipas pikës 2 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, janë përpara njërri prej rasteve të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, njoftojnë menjëherë Këshillin duke deklaruar arsyet konkrete që sjellin pengesë për pjesëmarrjen në veprimtarinë ose në mbledhjen e Këshillit lidhur me çështjen përkatëse.

### **Neni 15**

#### **Kuorumi i mbledhjes së Këshillit**

1. Mbledhja e Këshillit zhvillohet kur janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë të tij, dhe vendos me shumicën e votave.

2. Në rast se në ditën e caktuar nuk sigurohet kuorumi i nevojshëm, Kryetari apo sipas rastit Zëvendëskryetari ose anëtari që drejton mbledhjen, cakton një ditë tjetër sa më të afërt për zhvillimin e mbledhjes, dhe njofton për këtë anëtarët e Këshillit që nuk ishin të pranishëm.

3. Në rast të mospjesëmarrjes pa shkaqe të justifikuara në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit, si edhe të veprimeve a mosveprimeve që përbëjnë shkelje të tjera disiplinore sipas nenit 242 të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, Këshilli njofton menjëherë institucionet përkatëse që, sipas ligjit, kanë kompetencat për fillimin e procedimit disiplinor ndaj anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të Këshillit.

### **Neni 16**

#### **Punimet e mbledhjes së Këshillit**

*(Ndryshuar fjalia e dytë e pikës 3 me vendimin nr.1, datë 05.02.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi)*

1. Kryetari deklaron fillimin e mbledhjes së Këshillit, verifikon prezencën e anëtarëve dhe/ose anëtarëve zëvendësues, duke informuar Këshillin për motivet e mungesës ose të pengesës së anëtarit të Këshillit që nuk është i pranishëm, si edhe për thirrjen në atë mbledhje të anëtarit përkatës zëvendësues të tij.

2. Nëse nuk janë të njohura motivet e mosparaqitjes së anëtarit ose anëtarit zëvendësues, Kryetari ndërpret mbledhjen dhe, menjëherë, merr masa për ta kontaktuar anëtarin në mungesë, për tu informuar mbi mundësinë e paraqitjes në një kohë të arsyeshme dhe për të rifilluar mbledhjen. Kur nuk është i mundur komunikimi apo paraqitja e anëtarit në mungesë, mbledhja e Këshillit mund të shtyhet për tu zhvilluar, si rregull, në një ditë tjetër. Caktimi i ditës së mbledhjes bëhet duke pasur parasysh natyrën e çështjeve të rendit të ditës dhe nevojën për të respektuar rregullat dhe afatet procedurale të shqyrtimit të çështjeve konkrete.

3. Kur verifikohet kuorumi i vlefshëm për zhvillimin e mbledhjes, Kryetari paraqet çështjet e përcaktuara për shqyrtim në rendin e ditës. Këshilli merr vendime vetëm për çështjet të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

4. Pas miratimit të rendit të ditës, nëse anëtarët nuk ngrenë probleme të tjera të lidhura me ndonjërin prej rasteve të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, Këshilli vijon me shqyrtimin e çështjeve.
5. Kryetari i Këshillit jep fjalën, drejton debatin dhe përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës.
6. Anëtarët e Këshillit janë të detyruar të marrin fjalën lidhur me secilën çështje të rendit të ditës. Me përjashtim të anëtarit relator, si rregull, fjala e anëtarëve të tjerë nuk mund të jetë më shumë se 10 minuta.
7. Kryetari kujdeset që fjala të merret sipas radhës, si rregull, pa ndërprerje dhe debat të ndërmjetëm mes anëtarëve të Këshillit, përveç kur në mbledhje kërkohet të parashtrahet një çështjes procedurale për mënyrën e zhvillimit të saj.
8. Për secilën çështje të rendit të ditës, i pari merr fjalën, anëtari i Këshillit, i caktuar si relator dhe nismëtar i çështjes në shqyrtim. Në përfundim të relatimit, nëse e vlerësojnë, anëtarët e Këshillit i drejtojnë relatorit pyetje dhe kërkojnë sqarime lidhur me çështjen e relatuar.
9. Pas përgjigjeve sqaruese të anëtarit relator, marrin fjalën dhe diskutojnë anëtarët e tjerë të Këshillit, sipas renditjes së tyre që rezulton nga përzgjedhja me short e kryer nga Presidenti i Republikës ose Kryetari i Kuvendit.
10. Në vijim, nëse vlerësojnë të marrin përsëri fjalën, nën drejtimin e Kryetarit, anëtarët e Këshillit debatojnë lirisht pa ndonjë radhë të paracaktuar diskutimi.
11. Në përfundim të fjalës së anëtarëve të Këshillit, ftohet Avokati i Popullit për të shprehur mendimet e tij lidhur me mënyrën e procedimit dhe vlerësimet për çështjen. Pas Avokatit të Popullit ftohen për të shprehur mendimet e tyre subjektet e ftuara sipas pikës 2 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, të cilët, për çështjet e lidhura me verifikimin dhe vlerësimin e kandidatave mund të shprehen vetëm lidhur me mënyrën e procedimit të çështjes. Fjala e Avokatit të Popullit dhe secilit prej subjekteve të ftuar, si rregull, nuk mund të jetë më shumë se 5 minuta.
12. Pas mbylljes së diskutimeve mes tyre, anëtarët e Këshillit shprehin qëndrimin dhe votojnë për zgjidhjen e çështjes. I pari shpreh qëndrimin dhe voton anëtari relator i çështjes dhe në vijim anëtarët e tjerë sipas radhës së treguar në pikën 9 të këtij neni. Kryetari i Këshillit shpreh qëndrimin dhe voton i fundit.
13. Këshilli vendos me shumicën e votave në prani të të paktën pesë anëtarëve. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e Kryetarit është vendimtare.
14. Kryetari i Këshillit, përpara përfundimit të mbledhjes, propozon për diskutim ditën dhe kohën e zhvillimit të mbledhjes së ardhshme, si edhe çështjet e mundshme të rendit të ditës. Pasi Këshilli vendos për mënyrën se si do të procedohet, Kryetari deklaron mbylljen e mbledhjes.

## **Neni 17**

### **Dokumentimi i mbledhjes**

*(Ndryshuar titulli i nenit dhe pika 6, me vendimin nr.1, datë 05.02.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi)*

1. Kryetari i Këshillit është përgjegjës për të siguruar që personeli administrativ i vënë në dispozicion nga Gjykata e Lartë të marrë të gjitha masat e nevojshme që çdo mbledhje e Këshillit të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes:
  - a) regjistrimit audio;
  - b) procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes.



2. Kryetari i Këshillit ngarkon një sekretare nga punonjësit mbështetës të administratës së Gjykatës së Lartë për të mbajtur procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së Këshillit.
3. Në varësi edhe të natyrës së çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e Këshillit, procesverbali i mbledhjes përmban detyrimisht dhe në mënyrë të përmbledhur:
  - a) datën dhe orën e fillimit e të mbarimit të mbledhjes;
  - b) çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës;
  - c) anëtarët e Këshillit dhe/ose anëtarët zëvendësues të pranishëm;
  - ç) Avokatin e Popullit dhe përfaqësuesit e subjekteve të ftuar, kur kanë qenë të pranishëm;
  - d) subjekte të tjerë të thirrur apo të ftuar, kur kanë qenë të pranishëm;
  - dh) veprimet procedurale të zhvilluara në mbledhjen e Këshillit;
  - e) përmbledhje e diskutimeve të Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuar;
  - ë) rezultatet e votimit dhe dispozitivin e vendimeve të Këshillit lidhur me procedurat e verifikimit, vlerësimit dhe renditjes të kandidatave;
  - f) rezultatin e votimit mbi çdo vendim dhe qëndrim tjetër mbajtur gjatë punimeve të mbledhjes së Këshillit.
4. Procesverbali i përmbledhur, i dërgohet menjëherë për shqyrtim anëtarëve të Këshillit dhe anëtarëve zëvendësues të pranishëm në mbledhje, të cilët, jo më vonë se 48 orë nga dita e nesërme e ardhjes në dijeni, duhet të njoftojnë Kryetarin nëse kanë vërejtje për përmbajtjen e tij. Në rast se ndonjëri prej anëtarëve ka dyshime për saktësinë e përmbledhjes së procesverbalit, Kryetari i Këshillit urdhëron menjëherë ballafaqimin e përmbledhjes me regjistrimin audio dhe ndryshimin e saj në qoftë se dyshimi i anëtarit rezulton i justifikuar.
5. Procesverbali i përmbledhur, i dërgohet menjëherë për shqyrtim edhe Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesve të subjekteve të ftuara sipas ligjit, të cilët, jo më vonë se 48 orë nga dita e nesërme e ardhjes në dijeni, nëse kanë vërejtje për përmbledhjen e diskutimeve përkatëse të tyre, duhet të njoftojnë Kryetarin e Këshillit duke treguar njëkohësisht edhe pasaktësitë konkrete që vlerësojnë se përmban përmbledhja e diskutimit të tyre. Kryetari i Këshillit urdhëron menjëherë ballafaqimin e përmbledhjes me regjistrimin audio si edhe ndryshimin e saj në qoftë se vërejtja për pasaktësi në përmbledhjen e diskutimit përkatës rezulton e justifikuar.
6. Procesverbali i përmbledhur, pas korigjimeve sipas pikave 4 dhe 5, iu njoftohet menjëherë pjesëmarrësve në mbledhje. Ai shqyrtohet dhe miratohet si çështje e parë e rendit të ditës në mbledhjen pasardhëse të Këshillit, pas relatimit të Kryetarit mbi kërkesat dhe korigjimin e tij. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet anëtarët dhe/ose anëtarët zëvendësues që kanë marrë pjesë në mbledhje, si edhe nga personat e caktuar për mbajtjen e tij.
7. Procesverbali i përmbledhur, menjëherë pas nënshkrimit nga anëtarët e Këshillit, bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.
8. Procesverbal i përmbledhur, së bashku me regjistrimin audio të mbledhjes dhe transkriptimin e plotë të saj, depozitohen për ruajtje sipas legjislacionit në fuqi mbi arkivat, në zyrën e sekretarisë, protokollit dhe arkivës të krijuar posaçërisht për Këshillin pranë Gjykatës së Lartë.

### **Seksioni 3** **Transparenca dhe komunikimi me publikun**

#### **Neni 18** **Komunikimi me publikun**

*(Shtuar pika 3 me vendimin nr.1, datë 05.02.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi)*

1. Përveç sa parashikohet në pikën 4 të nenit 228, nenin 232 dhe në pikën 3 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje përmes një komunikate për mediat, e cila, sipas natyrës së çështjeve të trajtuara, informon së paku për:

- a) kohën e mbledhjes;
  - b) pjesëmarrjen;
  - c) çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës;
  - ç) thelbin e vendimmarrjeve të Këshillit
2. Në rastin e kryerjes së procedurave të shortit, të verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, sipas rastit, njoftohen publikisht në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë edhe :
- a) rezultatet e shortit mbi relatorin e pozicioneve vakante për çdo institucion;
  - b) jetëshkrimin e përditësuar i kandidatëve;
  - c) pozicionet për të cilat ata kandidojnë dhe institucionet propozuese;
  - ç) aktet e heqjes dorë të kandidatëve;
  - d) listën e kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur dhe të atyre që vijnë në konkurrimin;
  - dh) aktet lidhur me lejimin ose ndalimin e kandidimit;
  - e) listën që përmban renditjen e kandidatëve dhe listën e atyre kandidaturave që i paraqiten për vlerësim organeve kushtetuese të ngarkuara me zgjedhjen/emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ose për Inspektor të lartë të Drejtësisë;
  - ë) një shpjegim të shkurtër të procedurave dhe të metodës së ndjekur për verifikimin kushteve ligjore dhe të vlerësimit të kriterëve të përdorura për renditjen e kandidatëve;
  - f) përmbledhjen e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit;
  - g) aktin përfundimtar të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve.
3. Komunikata për publikun përgatitet nga Kryetari i Këshillit, i cili ia përcjell për mendim anëtarëve. Pas marrjes dhe reflektimit të mendimit të tyre, Kryetari i Këshillit urdhëron publikimin e komunikatës brenda 24 orëve nga zhvillimi i mbledhjes.

#### **Seksioni 4**

### **Veprimtaria përgatitore dhe mbështetëse për Këshillin**

#### **Neni 19**

### **Kompetencat e Kryetarit**

1. Kryetari i Këshillit drejton dhe bashkërendon punën dhe veprimtarinë e tij në zbatim:
  - a) të kompetencave dhe detyrimeve të përcaktuara në nenin 226 të ligjit nr. 115/2016;
  - b) të parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm për veprimtarinë e Këshillit;
  - c) kësaj Rregulloreje të Brendshme, akteve nënligjore normative dhe akteve të tjera rregullatorë të miratuara nga Këshilli;
  - ç) të detyrave të ngarkuara me vendim të mbledhjes së Këshillit.
2. Kryetari i Këshillit, në zbatim të kompetencave dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, veçanërisht:
  - a) ndërmerret të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Këshillit ;
  - b) koordinon veprimtaritë administrative në mbështetje të ushtrimit të kompetencave të Këshillit;

c) përfaqëson Këshillin në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë, por jo kufizuar këto marrëdhënie në bashkëpunime me institucionet e tjera, organet publike, organizata ndërkombëtare;

ç) nënshkruan vendimet dhe çdo akt tjetër që lidhet me ushtrimin e kompetencave të Këshillit dhe shkresat e ndryshme për komunikimin e këtij Këshilli me të tretët;

3. Në pamundësi objektive a pengesë ligjore të Kryetarit, këto funksione ushtrohen nga Zëvendëskryetari i Këshillit.

## **Neni 20**

### **Personeli administrativ dhe detyrat e tij**

1. Këshilli ndihmohet në veprimtarinë e tij nga punonjës të administratës së Gjykatës së Lartë, të caktuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit. Periudha e angazhimit, numri dhe profili i tyre caktohet sipas nevojave të përcaktuara nga Këshilli. Pasi caktohen, për këtë periudhë, këta punonjës kryejnë, sipas rastit dhe nevojës, me kohë të plotë apo të pjesshme, detyrat e ngarkuara nga Këshilli dhe anëtarët relatorë.

2. Përveç sa u kërkohet, rast pas rasti nga Këshilli, Kryetari dhe relatorët, personeli administrativ mbështetës kryen veprime lidhur me hartimin e procesverbaleve të mbledhjes, hartimin e shkresave apo akteve të ndryshme të Këshillit dhe relatorëve, mbajtjen e arkivës dhe protokollit të Këshillit, dërgimin dhe ndjekjen e njoftimeve, veprime të tjera të sekretarisë, veprimet për publikimin e njoftimeve dhe akteve në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë apo në media, si edhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e mbledhjeve dhe veprimtarive të Këshillit.

## **Neni 21**

### **Relatori dhe personeli mbështetës i tij**

1. Relatori i caktuar për shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve për pozicionet vakante, kryerjen e procedurave lidhur me verifikimin dhe vlerësimin e tyre, si edhe përgatitjen e projektvendimeve dhe akteve të tjera të lidhura me këto procedura, sipas rastit, mbështetet dhe ndihmohet nga një ose disa ndihmës ligjorë, sekretarë gjyqësorë dhe personel administrativ të Gjykatës së Lartë.

2. Kryetari, merr masat që, sipas rastit, relatorit të çështjes ti sigurohet numri i nevojshëm i ndihmësve ligjorë dhe personelit administrativ.

3. Caktimi i ndihmësve ligjorë pranë çdo relatori bëhet me short në mbledhjen e Këshillit.

## **KREU II**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

## **Neni 22**

### **Regjistrat, dokumentacioni dhe administrimi i çështjeve**

1. Rregullat e tjera të brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve caktohet me Rregullore të veçantë.

**Neni 23**  
**Dispozitë kalimtare**

1. Deri në miratimin e rregullave të përcaktuara në nenin 22 më sipër, për aq sa nuk parashikohet shprehimisht ndryshe në ligjin nr. 115/2016 dhe në këtë Rregullore të Brendshme, veprimtaria administrative mbështetëse, regjistrat, lëvizja, mbajtja dhe ruajtja e dokumentacionit të Këshillit bëhet duke u mbështetur dhe orientuar në parimet dhe dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi dhe rregullat e lëvizjes dhe të administrimit të dokumentacionit të Gjykatës së Lartë.

**Neni 24**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin nga mbledhja e Këshillit dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.